



Erasmus+



**ERASMUS+ INFO DAY
ALBANIA**

11 November 2015

Elona SARACI





Erasmus+



KA 1 - SHKËMBIMET PËR MASTER-a DHE DOKTORATA TË PËRBASHKËTA (DEGREE MOBILITY) NË ERASMUS MUNDUS DHE ERASMUS+

Aplikimet për master apo doktoratë

- ❖ Ky komponent mundëson kryerjen e një programi master apo doktorate, vetëm me kohë të plotë, në dy ose më shumë universitete evropiane me bursë Erasmus+.
- ❖ Një kusht i domosdoshëm për të aplikuar është njohja e gjuhës angleze dhe mbrojtja me një nga testet e njohura në rang ndërkombëtar si TOEFL-i ose IELTS-i.
- ❖ Diploma që lëshohet në fund të studimeve është diplomë e përbashkët, që njihet nga të gjitha universitetet evropiane.
- ❖ Aplikimet për Master ose PhD zakonisht hapen në muajin tetor dhe qëndrojnë të hapura deri në muajin dhjetor të çdo viti (*Në disa raste, mund të kenë afat deri në muajin janar të vitit pasardhës*)
- ❖ Bursat Erasmus+ mbulojnë të gjitha shpenzimet, përfshirë transportin, qëndrimin, pagesën e regjistrimit, sigurimin e jetës, kostot e vizës, etj.
- ❖ **Vini re:** Aplikimet për PhD do të jenë të mundura deri në vitin 2017. Krahas Erasmus+, aplikimet për doktoratë, post-doktoratë ose grante për kërkim shkencor do të mundësohen nëpërmjet komponentit Maria Sklodowska Curie, të programit ‘Horizon 2020 Framework Programme for Research and Innovation’.
- ❖ Për më tepër informacion, vizitoni linkun: <http://ec.europa.eu/research/mariecurieactions/>



Erasmus+



Si bëhet aplikimi?

- Si fillim, brenda listës së masterave dhe doktoratave të ofruara, identifikoni ato programe që përshtaten më tepër me studimet që keni kryer ose që janë të një fushe të përafërt.
- Lista e plotë e Master-ave të përbashkët Erasmus Mundus:
http://eacea.ec.europa.eu/erasmus_mundus/results_compendia/selected_projects_action_1_master_courses_en.php
- Lista e plotë e Doktoratave të përbashkëta Erasmus Mundus :
http://eacea.ec.europa.eu/erasmus_mundus/results_compendia/selected_projects_action_1_joint_doctorates_en.php
- Shqyrtoni informacionin e dhënë tek faqja e internetit e masterit/doktoratës që keni zgjedhur.
- Shikoni:
 - Udhëzimet për aplikimin;
 - Kriteret;
 - Afatin e fundit;
 - Kërkesat gjuhësore;
 - Dokumentet e tjera që mund të nevojiten për dosjen e aplikimit.
- ***Çdo master/doktoratë ka kritere dhe afate specifike!***



Erasmus+



- Dokumentet që kërkohen, përgjithësisht, përfshijnë:
 - Diplomën dhe listën e notave;
 - Dëshminë e gjuhës angleze të mbrojtur me IELTS ose TOEFL;
 - Letër motivimi;
 - Dy letra rekomandimi;
 - CV e aplikantit;
 - Dokumentin e identifikimit.
- Në rastin e PhD, mund të kërkohet një përshkrim i shkurtër i projektit shkencor që do të bëni.
- Në faqen e internetit të çdo Master-i ose Doktrate do të merrni informacion më të detajuar për kriterin gjuhësor, numrin e pikëve të kërkuara, rastet kur studimet e mëparshme janë kryer në këtë gjuhë etj.
- Sigurohuni që dokumentet e kërkuara të jenë të përkthyer në Anglisht dhe të noterizuara (në rast se nuk parashikohet në gjuhë tjetër).
- Aplikimi juaj bëhet VETËM online, nëpërmjet website-it të masterit/doktrates.
 - * Mund të aplikoni paralelisht, në 3 programe të ndryshme studimi, brenda të njëjtit nivel (dmth 3 Master-a ose 3 Doktorata të ndryshme). Nëse jeni fitues në 2 prej tyre, do të ndiqni vetëm njërin.
- Tregoni kujdes të respektoni afatin e fundit të aplikimit, pasi asnjë aplikim nuk do të jetë i vlefshëm po kaloi afati.





For more, visit
www.erasmusplus.nl